

FATMIR ZILJA



Kryeauditues, Departamenti i Auditimit të Pushtetit Qendror, Administratës së Lartë Publike, Menaxhimit Financiar dhe Auditimit të Brendshëm.

Lindur në vitin 1955. Diplomuar në Ekonomi, dega Industri(1979). Vjetërsia në punë 34 vite, nga të cilat 18 vitet e fundit në KLSH. Kryeauditues nga muaji shtator 2013. Eksperienca: Auditim i financave

publike.

STANDARD&POOR'S, RENDITJA E SHQIPERISE DHE KLSHⁱ

nga Fatmir Zilja

Së fundmi është transmetuar në media ulja e vlerësimit të riskut të kreditit të Shqipërisë nga Standard and Poor's. Në këtë shkrim shkurtimisht do të paraqesim çfarë janë sistemet e renditjes dhe ku bazohen ato, cila është renditja aktuale e Shqipërisë dhe faktorët që ndikojnë në këtë vlerësim, cili është pozicioni i Shqipërisë në raport me vendet e tjera të Ballkanit dhe çfarë kontributi mund të japë Kontroll i Lartë i Shtetit.

Risku i kreditit dhe faktorët përcaktues.

Rankimet e riskut të kreditit janë një nga instrumentet që investitorët përdorin në procesin e vendim-marrjes për të blerë letra me vlerë. Ato përfaqësojnë opinionet e agjensive si Standard and Poor's, Moody's, etj, në lidhje me aftësinë e një kompanie apo shteti për të paguar detyrimet financiare në kohë. Vlerësimet e riskut të kreditit janë të orientuara nga e ardhmja dhe përfshijnë të gjithë informacionin historik, aktual por edhe ngjarjet që pritet të ndodhin në të ardhmen, të cilat kanë impakt në gjendjen

ekonomike, ciklet e biznesit dhe aftësinë për të ripaguar huatë e marra. Zakonisht rankimi bëhet në shkallën ABC ku AAA përfaqëson nivelin më të lartë të rankimit, ndërsa C nivelin më të ulët të rankimit, (riskun më të lartë të kreditit, nivelin më të dobët të qëndrueshmërisë financiare).

Faktorët kryesor që merren në konsideratë gjatë vlerësimit të aftësisë paguese të detyrimeve financiare (risku i kreditit) të një shteti janë profili ekonomik, vlerësimi politik, vlerësimi ekonomik, situata politike e fiskale, situata dhe politikat monetare etj.

Nga këta, dy faktorë, vlerësimi politik dhe situatat politike fiskale janë në zonën e kuqe (më të paqëndrueshme, më riskioze) **në rastin e Shqipërisë.**

Rankimi i riskut të kreditit të Shqipërisë nga Moody's është i qëndrueshëm në nivelin B1. Ky rankim i atribuohet në pjesë të madhe sfidave fiskale që ka përpara qeveria shqiptare, ngritjes së nivelit të borxhit në raport me GDP dhe kontraktimit në rritjen ekonomike që pritet në vitin në vijim. Veçanërisht problematik, sipas Moody's shfaqet niveli i lartë i borxhit në raport me PBB, sepse Shqipëria ka akoma një sistem delikat dhe jo të konsoliduar të bankave, i cili paraqet karakteristikat e mëposhtme, jo shumë të favorshme:

1. Rritje të ngadaltë të mesatares së ponderuar të borxhit deri në maturim.
2. Një bazë të ngushtë investitorësh vendas.
3. Ekspozim të lartë ndaj riskut të kurseve të këmbimit.

Dy momente pozitive që parashikohet të balancojnë situatën financiare në vend janë:

- Marrja e statusit të vendit kandidat në Bashkimin Evropian dhe
- Ndërtimi i Gazsjellësit Trans Adriatik.

Standard and Poor,s e uli vlerësimin e riskut të kreditit nga niveli B+ në nivelin B. Arsyeja për këtë zhvlerësim është rritja e borxhit publik në raport

me PBB në nivelin 66% në baza neto. Faktorë të tjerë të cilët ndikojnë në këtë nivel të ulët rankimi janë: 1. Niveli i ulët i PBB për person.

2. Sistem i dobët ligjor i shoqëruar me nivel të lartë korrupsioni.

3. Rënia e remitancave nga Greqia dhe Italia.

4. Ngadalësimi i rritjes ekonomike në nivelin 1.3%.

Arsyeja kryesore për këtë rritje në borxhin publik sipas Standard and Poors është rritja e shpenzimeve qeveritare të lidhura me fushatën elektorale dhe mosmbledhja e tatimeve, shpenzimet totale u rritën me 7%, ndërkohë që mbledhja e taksave u pakësua me 8%.

Në ndryshim me Moody's që e ka vlerësuar të qëndrueshëm rankimin e riskut të kreditit të Shqipërisë, S&P ka pritshmëri negative që do të thotë se ekziston një probabilitet 33% (vlerësim i S&P) që do të thotë se rankimi do të përkeqësohet. Ky përkeqësim vjen si pasojë e rritjes së pamundësisë të qeverisë shqiptare për të rifinancuar borxhin e saj, në kushtet kur niveli i këtij borxhi është shumë i lartë.

Fondi Monetar Ndërkombëtar është shprehur gjithashtu se, problemi kryesor për ekonominë shqiptare, është rritja e borxhit publik. Veçanërisht shqetësuese është situata fiskale në gjysmën e parë të vitit 2013, ku niveli i taksave të mbledhura ishte i ulët, ndërkohë që pagesat e prapambetura të qeverisë vazhdojnë të akumulohen. Kjo situatë është veçanërisht e rrezikshme në një ambient ku normat e interesit janë të larta, pasi qeverisë shqiptare do t'i duhet të rifinancohet me kosto shumë të larta, ose të mos arrijë të "shes" huatë e saj për arsye se investitorët mund të sigurojnë kthime të larta edhe në investime alternative, të konsideruara më pak risikoze.

Nisur nga sa më sipër, blerja e letrave me vlerë të qeverisë shqiptare konsiderohet si investim spekulues.

Nëse e krahasojmë Shqipërinë me vendet e tjera të rajonit, konstatojmë se vetëm Greqia ka një risk krediti më të lartë. Qeveria shqiptare ka të njëjtin

risk me qeverinë e Bosnie Hercegovinës për të mos shlyer detyrimet ndaj kreditorëve përkatës. Ndërkohë, në shtetet e tjera ballkanike si Maqedonia, Serbia, Mal i Zi dhe Kroacia kanë aftësi më të mëdha pagueuese dhe, si rrjedhojë, ekonomike më të qëndrueshme se Shqipëria. Të dhënat për vlerësimin e riskun të kreditit për shtetet e sipërpërmendura janë paraqitur në tabelën më poshtë.

Vendet	S & P		Modody's	
	Vlerësimi	pritshtëria	Vlerësimi	pritshtëria
Shqipëria	B	Negative	B1	qëndrueshëm
Kroacia	BB+	Negative	Ba1	qëndrueshëm
Maqedonia	BB-	qëndrueshëm	-	-
Serbia	BB-	Negative	B1	qëndrueshëm
Greqia	B-	qëndrueshëm	Caa3	qëndrueshëm
Bosnie Herceg	B	qëndrueshëm	B3	qëndrueshëm

Në vlerësimin e mësipërm, dy problemet kryesore që haste Shqipëria sipas agjencive të vlerësimit, por edhe Fondit Monetar Ndërkombëtar janë: *rritja e borxhit publik* në raport me prodhimin e brendshëm bruto dhe *niveli i lartë i perceptuar i korrupsionit*.

Faktorët kryesorë që kanë çuar në rritjen e borxhit janë **mos mbledhja e taksave** në nivelin e duhur dhe rritja e shpenzimeve publike në mënyrë të paparashikuar.

Në këndvështrimin tim si auditues i KLSH ka disa elementë që ndikojnë në evazionin fiskal (mos mbledhjen e taksave), ndër të cilët mund të veçojmë:

- Orientimin e gabuar me vetëdije, të auditimeve të brendshme të DPT (numër i kufizuar i subjekteve me humbje, auditohen më shumë subjektet me më pak risk... etj),
- Lëvizjen, ndërrimin e shpeshtë të punonjësve të tatimeve, sidomos në kohën e ndërrimit të pushtetit, e cila shoqërohet me nivel profesional të ulët

të punonjësve të rinj dhe nuk lejon specializimin, kualifikimin e tyre në vazhdimësi,

- Mentaliteti i krijuar dhe i justifikuar nga koha se duke punuar në fushën e tatimeve mund të përfitosh lehtësisht,

- Pandëshkueshmëria e veprimeve abuzive të punonjësve tatimorë etj, dhe më i rëndësishmi është se

- Në DPT nuk ushtrohet auditim i jashtëm që prej vitit 2009.

DPT, me argumentin e ruajtjes së “konfidencialitetit”, në mënyrë të kundërligjshme dhe në vazhdimësi, nuk ka lejuar Kontrollin e Lartë të Shtetit që të auditojë në DPT dhe Drejtoritë Rajonale të Tatimeve, duke e lënë praktikisht pa kontroll këtë nyje jetike të mbledhjes së të ardhurave.

“Konfidencialiteti” që i mëshon MF, janë llogaritë vjetore të subjekteve privatë, dokumente që këta të fundit paraqesin rëndom në Institucione të tjera (bashki, komuna, ministri etj), sa herë që marrin pjesë në tenderë të ndryshëm, për tre vjet.

Në favor të këtij përfundimi flasin dhe statistikat e KLSH për dëmin ekonomik të shkaktuar në fushën e tatim taksave, si më poshtë:

Vitet	Njësi matje	Dëmi ekonomik Tatim taksa	% ndaj dëmit gjithsej
2006	000 L	4,782,279	65
2007	“	3,671,261	60
2008	“	1,887,633	47
2009	“	2,535,186	35
2010	“	535,682	33
2011	“	49,052	07
2012	“	38,078	-

Akoma më i rëndë bëhet akti i moslejimit për ushtrim auditimi nga DPT, në kushtet e skandaleve që janë evidentuar së fundmi, lidhur me skemat e

mashttrimit me rimbursimet e TVSH, të cilat kapin vlerën e disa dhjetëra miliona dollarëve dhe përbëjnë grupën e zezë të ekonomisë shqiptare.

Po nga të dhënat që disponon KLSH, nga auditimet e kryera në DPT për vitin 2010 dhe 2011 konstatohet se:

- Ritmi i rritjes së kreditimit të TVSH (kërkesa rimbursim për TVSH) nga një vit në tjetrin është më i lart se sa ritmi i rritjes së pagesës së TVSH për të njëjtën periudhë.

- E njëjta situatë është edhe për ritmin e rritjes së humbjes për llogari të tatim fitimit, e cila është më e madhe se sa vet pagesa e këtij detyrimi fiskal.

Në gjykimin tim, moslejimi i KLSH që të auditojë DPT nuk është thjesht veprim i saj, por edhe i segmenteve të caktuara me mbështetje *politike* dhe sot, për përfitime personale.

Nën arsyetimet e mësipërme fokusi duhet të vendoset në uljen e evazionit fiskal. Nëse minimizimi i tij nuk çon në uljen e borxhit publik në nivelet e kërkuara edhe nga institucionet ndërkombëtare, atëherë mund të konsiderohet e nevojshme rritja e nivelit të taksave ekzistuese ose vendosja e taksave të reja.

ⁱ Botuar në Gazetën "Ekonomia", date 08 janar 2014 (dorëzuar si shkrim në fund të vitit 2013).